

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nis viti i ri shkollor në gjithë vendin, më të emocionuarit të vegjlit, 25 mijë nxënës në klasën e parë – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/nis-viti-i-ri-shkollor-ne-gjithe-vendin-me-te-emocionuarit-te-vegjlit-25-mije-nxenes-ne-klasen-e-pare/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 13:06:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 13:05:07 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0d24c988016bcd7702ea5e8fea03421e0f46efc03ba32790bd3b4bb8006f3ffb
TEKSTI	d7dbf9fd45af626e60201607b8b5d85265741f9395c5180f331d114ab0ebc5f9
PAMJA	2e97a68e1fbed103145f4281ed876a80efb80d9545a90a5b944f7f6a8a96fb71

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b9f2308306d4d0ecdb06645e2f2f3c23a684204c26a27be7ea478b5a8b192bb7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0b6439cf09af002acf6ffba878872d12e4fabe601bb852ed9a98adac17b7c4e3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b9f2308306d4d0ecdb06645e2f2f3c23a684204c26a27be7ea478b5a8b192bb7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



dhe me lule në duar nxenesit hyne në klasa për të nisur kështu vitin e ri shkollor. Emocionet më të forta i përjetuan vogëlushët e klasave të para. Për rreth 25.000 fëmijë, kjo ditë shënoi hapin e parë drejt dijes.

“Shumë mirë. Njoha një vajzë, shqen time të parë. Do t’u the suksese!”

“Suksese të gjithë fëmijëve!”

“Suksese të gjithëve!”

“Kam ardhur me mamën, babin, nënën, gjyshin dhe vëllain.”

“Ka shumë shokë dhe shoqe.”

“Kam ardhur me nënën, dajën, mamën dhe babin.”

“Mua më pëlqejnë vizatimet dhe pikturat. Më pëlqen edhe se të gjithë do të kënaqemi në shkollë.”

“Gëzuar vitin e ri shkollor!”

Mes librave që do t’i shoqërojnë gjatë këtij viti, të vegjlit e kishin zgjedhur menjëherë të preferuarit e tyre.

“Nga të gjithë librat më pëlqen Abetarja, që të mësoj të gjithë numrat dhe shkronjat. Kam ardhur me mamën dhe gjyshin. Vetëm suksese!”

“Më pëlqeu Abetarja.”

“Matematika më pëlqen më shumë.”

5 Kishte dalë nga burgu me leje dhe duhej të kthehej sot, Alket Rizai...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emaili juaj

Abonohu

"Abetarja dhe Leximet."

Edhe mësuesit që do t'i udhëheqin fëmijët në hapat e parë të dijes nuk e fshehën emocionin e këtij fillimi.

"Uroj të gjithë fëmijët: suksese në rrugën e bukur të dijes. Jam krenare që do t'i udhëheq këta fëmijë. Jam e emocionuar; është brezi i tetë që marr. Emocionet sa vijnë e shtohen. Fëmijët në përgjithësi kanë emocione se është hera e parë për ta që ulen në bankat e shkollës. Megjithatë po shoh që po përshtaten shumë mirë me njëri-tjetrin", u shpreh Adelina Kraja, mësuese e arsimit fillor.

Ndryshe nga vogëlushët që e njohin shkollën për herë të parë, për nxënësit e klasave të nënta korridoret dhe bankat janë tashmë të njohura. Megjithatë, edhe për ta kjo ditë ka një emocion të veçantë.

"Patjetër ngaqë është viti i fundit kemi emocione sidomos për përgatitjet që duhet të bëjmë për testin. Megjithatë si vit i fundit duhet të kënaqemi sa më shumë. Për provimet e fundvitit do kemi pak frikë, por do na mungojë shumë shoqëria dhe momentet që kemi ndërtuar prej vitesh."

Këtë vit dita e parë e shkollës ishte konceptuar edhe si një ditë orientimi dhe informacioni.

"Është bërë një organizim më ndryshe se vitet e tjera, pra jo mësim, detyra shtëpie, por më tepër festë argëtuese që nxënësit të njihen me njëri-tjetrin, me shokët e rinj. Dotë njihen gjithashtu me rregulloren e shkollës. Këtë vit është theksuar mospërdorimi i telefonit në mësim."

20 shkolla janë tashmë nën monitorim në kuadër të projektit "Smart City", l cili, përmes kamerave inteligjente, synon të rrisë sigurinë në ambjentet e shkollës.

Gjithashtu, një tjetër risi është program pas shkolle, që do të zbatohet në 408 shkolla në të gjithë vendin.

#femije

#shkolle

#Tirane



Xhuljana Zhuleku

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh



VENDI

Përplasen dy automjete në rrugën...

Xhuljana Zhuleku

14 minuta më parë



VENDI

Tjetër skandal i vëllezërve Goxha,...

Xhuljana Zhuleku

27 minuta më parë



POLITIKË

Debate në Komision për "Kayo"! PD: A...

Xhuljana Zhuleku

37 minuta më parë

Lini një koment

Komenti juaj *

Me respekt — komentet moderohen nga redaksia.

Emri *

E-mail *

Nuk publikohet kurrë.

☐ Ruaje emrin dhe e-mailin tim në këtë shfletues për herën tjetër që komentoj.

Posto komentin



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.